

PROCESVERBAL- Nr. 1**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)***OBJEKTI I PROCEDURËS:****“Riparim-mirëmbajtje të ashensorëve në S. U.O.GJ. “Koco GLIOZHENI ”, Tiranë - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 2 vite (24 muaj)”****KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):****Shërbime të ndryshme për riparim dhe mirëmbajtje –****VLERA E FONDIT LIMIT: Fondi limit/Vlera e pritshme e Kontratave është: 6,999,900(*gjashhtë milion e netëqind e nentedhjet e nentemijë e nentqind*) **lekëpa TVSH, fondi limit për këtë procedurë është bazuar në studimin e tregut dhe reflektuar në proces-verbalin e fondit limit me Nr. 66/4 Prot, date 18.01.2023****

I	Kontrolle periodike ne 5 ashensoret TIP CLEMANN		
	Ashensor per shtreter 1400 kg, 2 (dy) , ashensor shtrati op. 400 kg 1(nje) dhe ashensoret personeli 400 kg 2 (dy) cope per		
	Kabina (dyshemese, dyerve,. ndriçimi ,Butonat hapje + mbyllje porte, Ventilatori , tavanet(pastrimet)		
1	regjistik operatori, kontakti I parashutes. Vajisje e shinave te kabina+k/peshave. Gominat e fiksimit kabine-arkade. Kontroll tokezimi kavo, kabine arkade. Gjendjen e fijeve flesibel.	o.p	250
2	Salla e makinerive: Pastrimi dhe ndriçimi I salles . Prove rregullatorit, valvoles se renies, kontroll i gjendjes se kavos se rregullatorit. Kontroll funksionimit te automateve. Prove dispozitivit . Gjendja ne teresi emergjences.	o.p	100
3	Arganello e ashensorit: Kontroll i nivelin e vajit ne reduktor. Kontroll i ventilatorit ftohes. Pastrimi i elektromotor, reduktor. Kontroll per xhoko vide-korone. Pastrimi i temburos se kontroll pulexhos el/motorit+devijimet, fortesise se sustes se frenit. Kontroll gjendjen e ferrotave te frenit.	o.p	100
4	Kafazi i ashensorit: Pastrimi, shtrengimi I stafave te shinave. Pastrimi, shtrengimi i dyerve te katit Kontroll i stafave te petashuqeve. Ndriçimi i kafazit. Tokezimi i shinave.	o.p	200
5	Kuadri i manovres: Kontroll zhurme leshues, rele etj. Shtrengim fije tek leshuesit dhe relet. Prove + regjistik termikun e thithjes. Kontroll tokezimit te kuadrit. Kontroll perqafimi i morsetave tek skeda. Pastrim	o.p	150

	skede, kontroll transformatori.		
	Arkaden: Kontroll dado tirante, morsetat e kavove. Kontroll morsetat e kavos se rregullatorit. Shtrengimi i bulonave te arkaden. Kontroll xhoko (hapsire) guarnicioneve. Gjendja e tirantit, prova e parashutes. Kontroll arkades, k/peshes dhe kovot. Vaisje shinave, kabine+kundrapesha. Gjendja fizike ne teresi	o.p	100
7	Gropa e ashensorit: Kontroll, pastrim i gropes. Kontroll i deviatorit dhe prizes. Kontroll i gjendjes se sustes + zinxhirit. Kontroll distc. kabine-k/peshe-susta. Kontroll kontakti kavos se rregullatorit. Kontroll gjedjes pulexhos	o.p	100
8	Portat e kateve: Kontroll i mbylljes mekanike te dyerve. Kontakti elektrik, çelosi i emergjences, pastrim i kases siper dhe i karelit. Kontroll- rregjistrim i hapsires ulave. Kontroll per konsumim, shtrengim i patinave rulat e akopjimit. Prove kontroll i zhurmes se deres ne hapje butonave + llampat e kateve	o.p	100
9	Te pergjithshme: Gjithnje behet kontroll I funksionimit te impiantit, alarmit, llampes se emergjences dhe manovren me dore.	o.p	100
	Ne çdo tre muaj behen keto verifikime dhe kontrolle: Funksionimin e alarmit pa tension, Konsumin, zgjatjen, rreshqitjen e kavove. Tokezimin e ashensorit. Limitatorin e shpejtesise, Kontroll i qarqeve te sigurise dhe mbrojtjes. Distanca kat-kabine (max 30 mm). Valvolen e renies, Efikasitetin e termikut.		
	Perforcim shasie dhe kabine		
	Pastrim dhe lucidim shinash		
10	Pastrim dhe lucidim inox dyer dhe kabine	o.p	100
	FV kontakte te dyerve te katit	Cope	30
	FV Rrula dyersh kati	Cope	120
	FV Rreshqitesa dyersh kati	Cope	100
	FV susta dyer te jashteme	Cope	24
	FV operator dere	Cope	2
	FV gershere per hapje dere	Cope	4
	FV fotocelule shirit	Cope	2
	FV butona	Cope	8
	FV spote LED per ndricim kabine	Cope	40
	FV udhezues i poshte i deres	Cope	2
	FV rreshqitesa dyer automatike	Cope	8
	FV dysheme antibakteriale	Cope	4
	FV stop i sistemit te frenimit (parashutes)	Cope	2
	FV pulexho e rregulatorit te shpejtesise + stop	Cope	2
	FV kavo per rregullatorin e shpejtesise	ML	70
	FV shirit led + mekanizem ndezje me litar	ML	60
	FV celesa fundore	Cope	4

FV rripa transmisioni te dyerve	Cope	4
FV kavo e deres automatike	Cope	4
FV rrethim mbi kabine	Cope	5
FV. Shkalle me stop ne pus	Cope	5
FV. Sinjalues akustik dhe optik poshte kabines	Cope	2
FV. Sistem citofonie	Cope	5
FV bateri 12v 12amp	Cope	8
FV panele LED per ndricimin e dhomes se makinerise	Cope	14
FV encoder motorri	Cope	2
FV kuzhineta te pulexhove ndihmese	Cope	16
FV inverter kryesor	Cope	1
FV sistem mbi peshe	Cope	2
FV tirante per kavot e kabines	Cope	12
FV sistem akses kontrolli me 30 Chipa	Cope	1
FV Reader RFID per akses kontrolli ekzistues	Cope	5
FV panele + sistem elektrik i kompletuar me butona kabine dhe kati	Cope	3
FV tavan i varur i ndricuar me spote LED	Cope	2
FV Opertor Dere i kompletuar bashke me fletet e dyerve	Cope	3
FV sistem frenimi i kompletuar me rregullator shpejtesie	Cope	3
FV mbrojtese te kundrapeshave ne gropen e ashensorit	Cope	3
FV kavo diameter 8mm	ml	300
FV rreshqitesa kabine + bazament	Cope	10
FV tirante per kavot e kabines	Cope	24
FV Panele ndricimi LED per kabinen e ashensorit	Cope	12
FV kavo diameter 10mm	ml	150
SHUMA		
TVSH.	20%	
TOTALI		

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor S. U.O. GJ ”Koco GLIOZHENI ”, Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Kriteri 2.2.1: Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave kësaj Proçedure Prokurimi.

Shënim*: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera jo më e vogël se 20 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar/vlerës së pritshme të Kontratave për të cilën ofertohej.

Nëse operatorët ekonomikë, në këtë proçedurë prokurimi, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këtë DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj proçedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se:

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Legjislatori në piken 1 dhe piken 2/b te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Proçedurën e Hapur, ku përcaktohet se:

Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: **b) vlerën e përlogaritit të kontratës ose lotit, në proçedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;** Vendosija e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterrojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj proçedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale te **xhiros jo me e vogël se 20% e vlerës së fondit limit*, për të cilë konkurron operatori, është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.*

Vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2021, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë afat deri më 31.03.2022. Ndërkohë, që xhiro vjetore e certifikuar për vitin 2022 ende nuk është realizuar, pasi OE ofertues kanë afat për përmbylljen deri më datë 31.03.2023.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 "Mbi Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore të ardhurave; *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo më e vogël se **20% e vlerës së fondit limit vlerës së pritshme të kontratave për të cilat konkurron operatori, është një deshmi e mjaftueshme për të krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zoterojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i nga AK i kësaj kerkese, lidhet me natyrën sensitive të shërbimit në kontekst të shërbimit publik dhe mjedisit, ndaj nga OE kerkohen parametra të lartë besueshmërie. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor për besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e tij.

(Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.).

Kriteri 2.2.2. Operatorë ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të(shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor).

(nuk është i aplikueshëm)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, 2019,2020,2021(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).(nuk është i aplikueshëm).

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Kriteri 2.3.1: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limitit të kësaj kontrate/vlerës së pritshme të kontratave.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera 20 % do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit/vlerën e pritshme të Kontratave për të cilën ofertohet.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së fondit limit/vlerës së pritshme të Kontratave, vlerë e cila është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Kjo kërkohet që Operatorët Ekonomikë ofertues të vërtetojnë aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK, referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

“3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.”

Eshtë kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën **minimumi 20% të fondit limit/vlerës së pritshme të kontratave për të cilët oferton Operatori Ekonomik**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.Kriteri 2.3.2:

a.) Operatori duhet të ketë çertifikatën **ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”/ose ekuivalente**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b.) Operatori, duhet të ketë çertifikatën **ISO 45001:2018 (për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë)** mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë” ose ekuivalente në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi për Kriterin 2.3.2 pikat: a dhe b: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Në bazë të nenit 79/1, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” si dhe neneve 41/4/a si dhe 44/1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i

plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita, Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. **Kriteri 2.3.3:** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

Kërkohej që ofertuesi të paraqesë një vërtetim për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik për periudhën **deri në tre muaj nga data e hapjes së ofertave**, numri i të cilëve të jetë minimumi 4 (kater) punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët

- 2 (dy) teknike ashensori
- 1 (nje) inxhinier mekanik
- 1 (një) inxhinier elektrikist

Për këtë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata tatimore së bashku me listëpagesat sipas formularit E-SIG 025, ku të pasqyrohen minimumi 4-kater punonjës për secilin muaj për periudhën e mësipërme dhe

Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:

• **Minimumi 1 (një) Inxhinier mekanik;**

– Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:

- CV përkatëse;
- Kopje e noterizuar e diplomës së Universitetit;
- Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me inxhinjerin e mekanik.

• **Minimumi 1 (një) Inxhinier elektrik ;**

– Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:

- CV përkatëse;
- Kopje e noterizuar e diplomës së Universitetit;
- Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me inxhinjerin e mekanik.

• **Minimumi 2(dy) teknikë ashensori;**

– Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga stafi më sipër:

- CV përkatëse;
- Kopje e noterizuar e çertifikatës ose dëshmië përkatëse;

- *Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme ose Kontratë Shërbimi e lidhur me teknikët e ashensorëve.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjesve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, apo të specializuar, kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Argumentimi pika 2.3.3: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Neni 41/4 b i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur Kontratën.

Gjithashtu, inxhinjeriështë vendosur të kërkohen nga AK me argumentimin se për ashensorët nevojitetposedimi i njëinxhinjerimekanik të trajnuar për riparimin dhe për realizimin e shërbimit të

mirëmbajtjes së Ashensorëve, si edhe nevojitet për të dëshmuar OE që i ka të gjitha kapacitetet dhe personat specialistë për evadimin e këtyre mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

4. Kriteri 2.3.4: Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoreshë prej **minimalisht 4 (katër) persona**, punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Në momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit (disponimin e punonjësve), OE fitues duhet të paraqesi dokumentacionin e përcaktuar më lart origjinal ose kopje të noterizuar të tij, në zbatim të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtoreshë të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Neni 41/4, pika c, i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar:

. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtoreshë të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Vendosja e këtij kriteri dhe përcaktimi kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtoreshë të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlogaritur si më poshtë:

minimumi 4 (katër) punonjës të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, ndër të cilët dy nga punonjësit duhet të jenë minimumi: dy teknikë ashensori një inxhinier mekanik, dhe një elektrikist, me qëllim realizimin me sukses të këtij Shërbimi.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë personelin që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

(Shënim- Specifikoni proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës së shërbimit, si dhe numrin e punonjësve të nevojshëm në çdo rast, bazuar në analizën e kryer).

5. **Kriteri 2.3.5:**Operatori ekonomik duhet të disponojë liçensën zbatimi **NS 3-Apër montimin e impianteve ngritëse dhe transportuese. (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).**Në përmbushje të kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë liçensën e zbatimit të shoqërisë.

Argumentimi per Kriter 2.3.5: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Neni 41/4, pika c, i VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar:

41/a/c.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) **mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.**

d) *Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.*

Referuar VKM nr. 759 datë 12.11.2014 “Për liçensimin profesional të individëve dhe personave Juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, sipas lidhjes 3/1 “Shpjegime për kategoria të në fushat e mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim.”, i ndryshuar.

N.S-3“Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)” argumentohet si më poshtë: Konsiderohet, montimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transp ortit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion automjetet për të përmbushur elementet e kontratës (transportin), të nevojshme

për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu, nisur nga fakti se ky shërbim është çdo ditë, ose edhe dy herë në ditë, janë kërkuar dy makina për evadimin e mbetjeve urbane, me argumentimin se nëse pëson difekt një makinë është makina tjetër në dispozicion.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit si dhe do të verifikojë në vend funksionimin e impianteve të paraqitura, duke asistuar realizimin e një cikli pune nga seicili.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.

- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.

- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT